

VENDIM
Nr. 206, datë 21.7.2026

MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR
100 mw

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1611/8 prot., datë 16.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611 prot., datë 15.5.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 100 Mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 145, datë 28.5.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.5.2026 dhe 1.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1611/3 prot., datë 3.6.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për fillimin e kësaj procedurë. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezultoi të ketë ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Me shkresën nr. 1611/4 prot., datë 3.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me dokumentacionin/informacionin që duhet të plotësohet.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611/5 prot., datë 15.6.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues.

- Në vijim, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, MIE, ka bërë me dije, ndër të tjera, se: referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar

nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë modifikimet që lidhen me numrin e paneleve dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njësisë të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të Bordit të ERE-s, lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, sipas të cilit ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, vlerësohet se ky qëndrim përbën një element paraprak të nevojshëm për vlerësimin e plotë të ligjshmërisë së kërkesës për modifikimin e licencës. Për këtë arsye, vlerësohet pezullimi i afatit të vendimmarrjes së bordit deri në marrjen e këtij sqarimi.

Pezullimi i vendimmarrjes

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Referuar qëndrimit të MIE-s, të paraqitur me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, në të cilin evidentohet se ndryshimet e propozuara nga shoqëria duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe me kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe subjektit, ERE vlerëson se, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar mbi kërkesën për modifikimin e licencës, është e nevojshme të sqarohet sa më sipër me MIE-n për verifikimin e ekzistencës ose jo të një kërkesë ligjore apo kontraktore që mund të kushtëzojë realizimin e ndryshimeve të kërkuara nga licencuari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.1.2025, për prodhimin e energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe afati i vendimmarrjes vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petraq Lika